



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III
Komisioni për Integritim Evropian
Mbledhja nr. 41
Prishtinë, më 16. 09. 2009, në orën 11: 00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Integritim Evropian

Morën pjesë: Zylfije Hundozi, Bujar Bukoshi, Hydajet Hyseni, Edita Tahiri, Fatmir Rexhepi, Nait Hasani, Naser Rugova dhe Mursel Halili.

Munguan: Džezair Murati, Sabri Hamiti dhe Njomza Emini.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha dhe Adelina Demolli.

Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi - kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 26. 06. 2009, 02. 07. 2009 dhe 06. 07. 2009;
3. Takim me ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, Sadri Ferati;
4. Njoftimi i Komisionit me ekspertin e BE- së për përkrahje Komisionit për Integritim Evropian;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 26. 06. 2009, 02. 07. 2009 dhe 06. 07. 2009;

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

4. Njoftimi i Komisionit me ekspertin e BE-së për përkrahje Komisionit për Integritet Evropian;

Për shkak të vonesës së ministrit, kryesuesja e prezantoi ekspertin Kaloyan Simeonov, i cili për gjashtë muajt e ardhshëm do ta ndihmojë Komisionin për harmonizimin e legjislacionit të Kosovës me atë të vendeve të BE-së.

Kaloyan Simeonov – I njoftoi për eksperiencën e tij njëmbëdhjetëvjeçare në fushën e integriteteve evropiane.

Anëtarët e Komisionit u prezantuan dhe shprehën gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar me të.

3. Takim me ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, Sadri Ferati;

Kryesuesja – I njoftoi se qëllimi i këtij takimi ka qenë të merreshin informata për procesin e decentralizimit dhe të ndarjes së pushtetit lokal.

Sadri Ferati - Tha se me shpalljen e Kosovës shtet, institucionet e saj kanë shprehur përkushtimin për zbatimin e propozimit gjithëpërfshirës për statusin e Kosovës, që është inkorporuar në Kushtetutën dhe në legjislacionin e Republikës së Kosovës. Reformimi dhe decentralizimi i pushtetit lokal është një nga proceset më të rëndësishme që rrjedhin nga ligjet e reja të miratuara nga Kuvendi i Kosovës. Zbatimi i këtij procesi kërkon plan të veprimeve, që duhet të ndërmerren dhe një qasje ndërsektoriale për të siguruar zhvillimin e një sistemi të decentralizuar të vetëqeverisjes lokale. Për këtë arsye Qeveria e Kosovës ka miratuar Planin e veprimit për zbatimin e decentralizimit dhe është themeluar Grupi Ndërmintor për Decentralizim, i bashkëkryesuar nga ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Pieter Feith. Ky grup ndërmintor është përgjegjës për bashkërendimin e politikave e të veprimeve për themelimin e komunave të reja dhe për zbatimin e procesit të decentralizimit në Republikën e Kosovës. Theksoi se në muajt e fundit përpjekjet më të mëdha janë fokusuar në krijimin e kontakteve me përfaqësues të komunitetit serb në Mitrovicë, ku është synuar të krijohen marrëdhënie për bashkëpunim me mediat serbe dhe me organizatat qeveritare.

Fatmir Rexhepi – Kërkoj që sa më parë në Kuvendin e Kosovës të iniciohet një debat për çështjen e pronave dhe për kompetencat e komunave për pronat. Shumë komuna kanë mbetur pa një pjesë të madhe të pronave, andaj në të ardhmen do të kenë mundësi të krijojnë partneritet publiko-privat. Sa i përket çështjes së reformës së pushtetit lokal është dashur të kemi informata të hollësishme dhe komplete nga Ministria e Pushtetit Lokal, se ku ndodhet ky proces. Lidhur me sistemin zgjedhor jemi në prag të zgjedhjeve lokale, prandaj duhet të rishqyrtohet edhe një herë propozimi për udhëzimin administrativ dhe të vepohet në pajtim me nevojat që i duhen këtij sistemi zgjedhor, sepse ligji mund të hartohet më vonë. Njerëzit mund të dalin në zgjedhje e të zgjidhen, pastaj të vendosin se në cilin post do të qëndrojnë.

Naser Rugova - Tha se reformat nuk janë të lehta as për vendet me demokraci të zhvilluar dhe të qëndrueshme. Me të gjitha mungesat që i kemi, si në aspektin legjislativ, të përvojave, të kapaciteteve, procesi i decentralizimit është një proces shumë i rëndë, që buron nga Pakoja e Ahtisaarit, ndaj së cilës kemi obligime institucionale dhe ndërkombëtare. Në procesin e decentralizimit duhet të jemi racionalë dhe unikë në zbatimin e drejtë të këtij procesi. Ka mangësi të informatave dhe të të dhënave sa i përket kësaj fushe nga institucionet tona. Kemi disa kompetenca të zgjeruara, që parashihen në Pakon e decentralizimit dhe që kanë të bëjnë me shëndetësinë sekondare,

me çështjen kulturore, me arsimin parauniversitar e me strukturat menagjeriale të policisë. I inkurajoi të vazhdojnë të punojnë në suaza të Pakos së Ahtisaarit, ndërsa kompromise ad hoc nuk duhet të ketë, sepse nuk ka kompromis për çështje të votuara në Kuvendin e Kosovës. Kërkoi që të punohet më shumë në Grupin e punës për ngritje të kapaciteteve dhe për koordinimin me donatorët. Këto janë procese që kërkojnë fonde e që fatkeqësisht për to nuk janë paraparë fonde në kornizën afatshkurtër dhe afatmesme të shpenzimeve. Kërkoi të debatohet në Kuvend për qëndrueshmërinë e komunave të sistemit 5+1, sepse edhe me Pakon e Ahtisaarit kërkohet që pas tre vjetve të bëhet një analizë për qëndrueshmërinë e tyre. Ngriti çështjen e Ligjit për pronën, sepse kjo paraqet një ndër problemet kryesore. Sa i përket mosmbajtjes së zgjedhjeve në Mitrovicë, e kuptojmë situatën sensitive, por duhet ta marrim një vendim në Kuvendin e Kosovës, që reformat të vlejné në tërë territorin e saj.

Edita Tahiri – Theksoi se çështja e decentralizimit dhe e zgjedhjeve lokale do të duhej të ishin në agjendën e të gjitha institucioneve të Kosovës, veçmas të Kuvendit të Kosovës. Decentralizimi, sipas Pakos së Ahtisaarit dhe Kushtetutës, është një ndër ofertat më të mira për minoritetet, sidomos për atë serb, që të marrin pushtet, ndoshta edhe më shumë se sa u takon në nivelin lokal. Institucionet e Kosovës kanë shprehur përkushtimin për integrimin e minoriteteve, por pengesat më të mëdha vijnë nga Beogradi. Institucionet e Kosovës, edhe pas dhjetë vjetve nuk kanë arritur ta hartonin asnjë rezolutë për Mitrovicën. Sa i përket Mitrovicës, ju thatë se atje nuk veprojnë ligjet e Kosovës, ndërsa liderët tanë vazhdimisht thonë se po shtrihen pushteti dhe ligji në tërë territorin e Kosovës. Tani kjo është barrë e të gjithë aktorëve politikë. Pyeti pse nuk kemi strategji apo ministri për Veriun e Mitrovicës deri sa të bëhet integrimi i saj? Sa i përket debatimit të çështjes së Veriut në Kuvend, si sponsoruese kam parashtruar dy herë mocion, mirëpo në të dyja ka pasur tërheqje të nënshkrimeve nga ana e deputetëve, prandaj konsideroi se edhe deputetët në këtë drejtim kanë dështuar. Njoftoi se në takim me kishte me zëvendësin e kryeministrit, Gjukanoviq, i është thënë se Mali i Zi është i gatshëm të krijojë marrëdhënie diplomatike me Kosovën, por të zgjidhet çështja e minoritetit rom, që ka jetuar në Kosovë. Sa u përket rregullave të ndëshkimit të shërbyesve civilë, me nga dy rroga, po përpiqen të ndikojnë në dobësimin e qeverisjes lokale, sepse vlerat tona qytetare dhe profesionale, gjenden pak a shumë në këta sektorë të shërbimeve civile. Kjo është politikë e verbër për të zvogëluar cilësinë e përfaqësimit për zgjedhje. Nëse revidohet ky udhëzim, nuk do të rregullohen shumë çështje, mirëpo me gjithë atë do të përmirësohet sado pak gjendja.

Bujar Bukoshi - Theksoi se për këtë çështje ka shumë kundërthënie dhe polemika. Ju e filluat prezantimin duke e kualifikuar punën tuaj, si punë shumë të suksesshme. Kërkoj të debatohet që kjo çështje të zgjidhet sa më mirë. Në punën tuaj të mos bëhemi pjesë e problemit, sepse nëse pala shqiptare ofron, ndërsa pala serbe refuzon, atëherë del se ne po u ofrojmë diçka të keqe. Kërkoi të jenë kritikë për punën e tyre. Kosova me Kushtetutë dhe me Pakon e Ahtisaarit e ka mekanizmin më të mirë të mbrojtjes së minoriteteve. Pyeti si është akceptanca e serbëve për decentralizimin, për vështirësitë me propagandën kundër pranimin të decentralizimit dhe për strukturat ekstremiste të serbëve në Mitrovicë. Ne, si Komision, mund të japim kontribut të madh në këtë drejtim.

Mursel Halili – E falënderoi ministrin për pjesëmarrje në Komision dhe tha se deri më tani u përmend vetëm Veriu, por Kosova, siç e ka Veriun, e ka edhe Jugun, ku jeton komuniteti goran, në atë numër të mjaftueshëm që Ligji lejon të formohet pushteti lokal. Kemi komunikuar me Ministrinë e Pushtetit Lokal. Për këtë ju kemi njoftuar, sepse dëshira e komunitetit goran është t'i realizojë të drejtat e veta dhe njëkohësisht të marrë përgjegjësi për veprimet e veta dhe të

jetohet më mirë, sepse na akuzojnë se jemi destruktivë, por në të vërtetë nuk na jepet rasti t' i zgjidhim problemet tona dhe t' i marrim përgjegjësitë për veprimet tona. Në vazhdim pyeti se a është ndërmarrë diçka për fillimin e procesit të bisedimeve, për formimin e pushtetit lokal, të caktuar me ligj. A mendoni se goranët i plotësojnë kushtet për t' i realizuar të drejtat? Ne do të dalim në zgjedhje, siç kemi dalë gjithmonë dhe do të japim kontribut. Kemi parë se ne dhe komunitetet e tjera të Dragashit, nuk luajmë rol të rëndësishëm. Tani nuk dua ta kualifikoj përse, por ju lus ta merrni parasysh pyetjen time.

Hydajet Hyseni - Kërkoj falje sepse kishte ardhur me vonesë dhe nuk e kishte dëgjuar ekspozën e ministrit, por tha se duke e lexuar materialin e shkruar në raportin e ministrit të pushtetit lokal, që kishte arritur në Komision për zbatimin e decentralizimit, pyeti a është ky emërtim i saktë për decentralizimin. P.sh. tha çka ka këtu për decentralizimin e 90% të popullsisë së Kosovës, të territorit dhe të pushtetit, mund të thuhet më saktë decentralizimi etnik, vetëqeverisja etnike. Në pjesën e dytë thuhet se ligji parashikon themelimin e 5+1 komunave të reja, në vendet me shumicë të komunitetit serb. Kjo që kemi tash dhe ajo që bën ministria e juaj, është në 5 +1 komuna të profilizuara të bëhen komuna me baza etnike. Të gjithë e dimë se kjo është larg konceptit të decentralizimit të qeverisjes demokratike. A ka ndonjë analizë se cilat kanë qenë efektet e shndërrimit të Zveçanit në komunë dhe çka ka pasur pozitive? A kanë lidhje këto vështirësi që po dalin përtej urës me këtë zgjidhje, sepse në raport thuhet se do të ketë analizë pas 3 vjetësh. Nuk e mohoj kriterin etnik, si një nga kriteret e organizimit territorial, por kriteri etnik ekskluzivisht vetëm për një komunitet është treguar kontraproduktiv në përvojën tonë dhe a është analizuar kjo linjë? P.sh. për 50 vjet pushteti serb ka bërë përpjekje me lloj - lloj konceptesh të decentralizimit që ta favorizojë një komunitet në dëm të komunitetit tjetër, por efektet pikërisht kanë qenë fatale dhe negative pikërisht për komunitetin serb me logjikën e diskriminimit pozitiv. Pyeti ministrin se a e dëmton apo e ndihmon tash vazhdimi i kësaj logjike të diskriminimit pozitiv komunitetin serb? Sipas mendimit tim tha se e dëmton dhe këtë e ka dëshmuar përvoja jonë. Në Gjilan, në vazhdim tha se kishim pas formuar një koncept të funksionimit qytetar, ku komuniteti serb ishte relativisht mirë i integruar në strukturat e Kosovës. Liria e qarkullimit ka qenë pa vërejtje, funksiononin tregjet e përbashkëta etj. Në vend se të shfrytëzohet ky koncept i qytetërimit dhe të bartet edhe në Veri e në viset tjera, ne na u bart në Gjilan koncepti i ndarjeve etnike. Efektet çfarë janë? Për përshtypjen time janë negative dhe kontraproduktive.

Kosova ka bërë zgjidhje absurde favorizuese për një komunitet, e diskriminim për komunitetet e tjera, sidomos për shumicën. Por pasi që kemi hyrë në obligime të tilla, ne mbetemi vendi sikur nuk i përmbushim standardet, andaj pyeti ministrin; çka janë standardet, si i konsiderojnë standardet dhe si do të dukeshin jashtë Kosovës? Si do të dukeshin këto standarde dhe si do të shtrohej kjo çështje në Preshevë, Sanxhak etj. A është standard evropian që Vërboci dhe Kllokoti mund

të jenë komuna, kurse Pozharani, që është 10 herë më i madh nuk mund të bëhet komunë, a është ky standard evropian?

Pastaj sa i përket çështjes së emërtimeve jemi zotuar se do ta zbatojmë Ligjin për emërtime të vendbanimeve. Në një dispozitë të tij thuhet se të gjitha komunitetet nuk kanë drejtë të vendosim për emërtimin e vendbanimeve të tyre. Këtë nuk e ka kontestuar askush, por me Ligj janë emërtuar, në kundërshtim me të gjitha format e emërtimit deri më tani. Nuk ka qenë Llashtica -Vllashticë dhe Lladova Vlladovë dhe me çfarë të drejte banorët e këtyre vendbanimeve të vendosin për emërtimet e tyre. A është ky standard evropian?

Pastaj çështja e mbrojtjes së monumenteve, jemi dakord që të mbrohen të gjitha monumentet, por të ndahen me ligj vetëm monumentet ortodokse, kjo na vë në siklet, sepse është shkelje e standardeve evropiane dhe në kundërshtim me parimet e UNESCO-s, sepse nuk përfillet një çështje e tillë etnitizuese ose të besimeve fetare. Si t' i përmbushim standardet në sfida të këtilla. A mund të kërkojmë ne të standardizohen standardet, që ne të mbetemi konsistentë në qëndrimet tona, për të qenë vend shembullor në përmbushjen e lirive dhe të të drejtave të minoriteteve. Për një kujdes të veçantë favorizues jemi të gjithë dakord, por jo për një kujdes obstruktiv, sepse kjo po bëhet kontraproduktive. Presim kontributin tuaj Ministër. Shohim se Ministria angazhohet në disa çështje të pasurisë, çka nuk është kompetencë e juaj. Ne presim kontributin tuaj në emërtime dhe në procesin e etnizimit, sepse kjo ndihmon procesin.

Ministri Sadri Ferati - Në përgjigjen e tij tha se disa procese të decentralizimit në ambientet siç është Kosova, nëse konsiderohet se është obligim dhe interes, do të jetë detyrim i shoqërisë kosovare dhe të mos mendojmë se vetëm Ministria dhe Qeveria së bashku, mund t' i shpejtojmë ligjet dhe rezultatet do të jenë më të mëdha. Në një pjesë të diskutimeve nuk mund të ndërlihet, sepse konsideron se nuk është në fazën e disenjimit, është dhënë detyrë ta korrigjojë Pakon e Ahtisaarit. Jam ithtar i mbështetjes që nga ky komision të dalim me një debat si ta trajtojmë më tutje pronën shoqërore. Për Urdhëresën administrative 2002/3 tha se nuk e kam fuqinë ta ndërroj. Krejt ç' kam bërë, të mos ndodh që para 2 vjetve një ministër të mos e jepte variantin A, kurse tjetri variantin B. Mirëpo mund të dalë sugjerimi nga ky komision që aty ku munden Kabineti qeveritar dhe Kuvendi ta ndërrojnë këtë urdhëresë deri në implementimin e ligjit. Mendoj sa u përket përgjegjësive kemi qenë shumë transparentë, po nëse kërkohen shpjegime ende jemi këtu të japim shpjegime. Nuk kemi qenë në situatë fare të bisedojmë për kompromis. Sa u përket kompetencave, përveç pronave, çdo gjë ka shkuar normalisht. Procesi i decentralizimit është një strategji, ndarja e pushtetit është treguar në botë, si formë e mirë që të eliminohen dallimet dhe të krijohet një parakusht, të gjithë të ndihen mirë. Ka edhe nënstrategji, nëse mirë i analizojmë dhe i implementojmë do ta bëjmë më të lehtë synimin tonë. Sa i përket shërbyesve civilë, që do të marrin pjesë në fushatën zgjedhore, asnjëri që zgjidhet nuk mund të ushtrojë veprimtari komunale, aty ku nuk kam fuqi ta ndërroj, sepse ende mund të jem pjesë e iniciativës që më përket. Sa i përket

përgjegjësi të pjesës që referoj, mendoj se kam qenë mjaft transparent, por nuk kam dashur t'ju lodh me nëndetaje, kurse sa i përket pushtetit lokal nuk kemi qenë në situatë të bisedojmë për kompromise, por kemi qenë në aso gjendje në zbatimin e ligjeve të Republikës së Kosovës. Kurse sa u përket kompetencave, ka shkuar normalisht, përveç pjesës së pronave. Kurse sa i përket riadhesimit të romëve nga Mali i Zi, vlerësoi se riadhesimi është i mirë për të gjithë, por kjo është kompetencë e ministrisë adekuate. Sa i përket Mitrovicës, mendon se nuk është përgjegjësi vetëm e një Ministrie, por e të gjithëve, sepse duhet të shihet çka kërkon arsimi e çka shëndetësia. Nëse ne ndërtojmë një mbështetje për Mitrovicën, tregtia ka interes, shoqëria civile dhe mediat na trajtojnë mirë. Së pari duhet të krijohet një ambient dhe një pozicion, që tani nuk i kemi. Shihet një rrugë e mundshme, por me një mbështetje më të fuqishme të këtyre ideve që i prezantova, të begatuara edhe me idetë tuaja. Lidhur me decentralizimin theksoi se pas tre vjetësh mund të bëhet një analizë. Mirëpo nuk kam mandat të flas, sa është decentralizimi koncept i qëlluar. Kërkoj mirëkuptim sa u përket vlerësimeve. Konsideroj se është i shkëlqyeshëm angazhimi, sepse ka progres me një pjesë të serbëve të kyçur. Progresi në ndërtimin e konceptit është i shkëlqyeshëm. Hartimin e ligjeve sipas Pakos së Ahtisaarit, pjesëmarrja në aktivitete dhe krijimi i mundësisë për ekipet përgatitore dhe për komunat. Kjo dëshmon se sa jemi seriozë dhe se mirë bashkëpunojmë me partnerët ndërkombëtarë. Ne nuk kemi qasje fizike në Veri, por ambiciet janë për zhvillimin e këtij procesi. Jemi shumë këmbëngulës për një prezencë të pushtetit në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Para 15 nëntorit do të dalim me një qëndrim, se cila është qasja dhe strategjia jonë për një prezencë fillestare. Dua të kemi zyre në çdo lokalitet dhe të më jepet mundësi të krijohen alternativa dhe qytetarët të vendosin a ka interes të vijë në zyrën e Republikës së Kosovës. E shfrytëzoj rastin të them se kemi raste alogjike dhe Kuvendi dhe Qeveria do ta ketë analizën tonë pas zbatimit. Kjo është faza e parë e decentralizimit dhe për këtë kërkoj mirëkuptim, sepse ka qenë mjaft e rëndë. Krejt çka shkruan në Pakon e Ahtisaarit është detyrim, por nuk është pengesë për zhvillim. Ai detyron 5+1 komuna, por nuk ndalohej të formohen edhe 30, por ka qenë vendim yni, që për periudhën 2008 - 2010 të jenë kaq. Ne do të jemi në mbështetje të të gjitha analizave dhe të kërkesave të të gjitha lokaliteteve. Në fazën e dytë nuk do të ketë kriter etnik, por kriter të standardeve dhe do të merren parasysh kriteri gjeografik, qëndrueshmëria ekonomike, si dhe kriteri strategjik. Në vazhdim tha se kemi qenë të gatshëm ta bëjmë ligjin për emërtime, që është duke stagnuar. Kemi nevojë për debat dhe mbështetje të Parlamentit. Ne po bëjmë përpjekje dhe dëshirojmë mirëkuptim nga partnerët ndërkombëtarë dhe faji i mospësuksit nuk duhet t'u faturohet institucioneve të Kosovës, por gjetja e mekanizmave që institucionet e Kosovës të dëshmojnë sa janë në gjendje ta zhvillojnë jetën në shtetin e vet, në raport të barabartë të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Edita Tahiri - Vlerëson se është dashur të vinte ministri në Komision, sepse u hapen shumë tema. Konceptin e keni të gabueshëm, sepse është gabim, në shtetin tënd të hapësh alternativë zyre dhe kujdes për fjalorin, sepse kjo tregon se dikush tjetër është njëshi, ndoshta është gabim fjalori! Nuk jeni përgjegjës për mungesë të strategjisë, sepse 10 vjet të mungojë strategjia, është e palejueshme. Nuk keni strategji për Veriun e Kosovës dhe nuk është vetëm decentralizimi strategji. Nuk po kërkojmë strategji, por për elemente të strategjisë, duam bashkë të punojmë dhe të gjejmë strategji. Në vazhdim e pyeti ministrin për disa elemente të strategjisë;

1. A keni strategji për zhvillimin ekonomik dhe

2. A keni strategji për ndërkombëtarizimin e këtij problemi dhe për kërkimin e fakteve për kushtëzimin e Serbisë për integritet evropian me Veriun e Kosovës. Pse nuk e dëgjuam reagimin e Ministrisë së Pushtetit Lokal, si reflektohet çështja e protokollit. Asnjë institucion tjetër nuk ka reaguar, prandaj na duhet strategjia. Me protokollin çka na ndodhi, dështuam si shtet i ri dhe krijuam tensione me BE-në dhe me Amerikën. Në fund iu drejtua ministrit me fjalët: Merrni rekomandimet dhe të bashkëpunojmë për të ecur përpara, sepse këto punë janë strategjike.

Fatmir Rexhepi - Mendon se këtë vit duhet të hyjë në agjendë çështja e pronës, sepse Agjencia e pronës i ka marrë kompetencat. Kryeministri mund ta iniciojë, kurse ministria dhe agjencia mund ta bëjnë këtë punë për një javë. Ka mundësi ta bëni një memorandum, lidhur me pronat shoqërore për komunat, sepse po na mbesin komunat pa prona. Në vazhdim kërkoi nga ministri, që sipas mundësive që i ka para vetes, të ndërmarrë dhe ta shikojë çështjen e Gjilanit, çështjen e vijës administrative.

Ministri- Sadri Ferati - E mbështeti diskutimin e parafolësit. Tha se është pjesë e angazhimeve të mia që me zbatim kemi për detyrë, por nuk është përfunduar deri sa nuk përfundon analiza.

Por, sa i përket diskutimit të deputetes Tahiri, tha se është një keqkuptim, sepse kam thënë *të kem zyrë* në pjesën Veriore dhe të ofroj alternativë për zgjidhjen e problemit. Insistoj për prani të institucioneve të Republikës së Kosovës në Veri.

Mursel Halili – E pyeti ministrin se kur do të zbatohet neni 10 i Ligjit për kufijtë administrativë të komunave, lidhur me fillimin e bisedimeve ndërmjet Qeverisë, Ministrisë dhe përfaqësuesve ndërkombëtarë, sepse konsideron se Kosova nuk do të humbë asgjë. Nëse fillojnë bisedimet, do të realizohen të drejtat, jo vetëm të komunitetit goran, që jeton në atë pjesë, por edhe komuniteteve të tjera, do t'u mundësohet njerëzve të jetojnë më mirë. Frikësohem se ajo pjesë do të mbetet pa njerëz. Me këtë Kosova do të humbë shumë.

Hydajet Hyseni - Tha se vërejtja e tij ishte konkrete, sepse duke lexuar raportin e pushtetit lokal për zbatimin e decentralizimit, nënkuptohet se fjala është për tërë Kosovën, në brendi është i pjesshëm!

A është gjithkund decentralizimi, nëse është centralizim nga Prishtina dhe centralizim nga Beogradi, a është kjo formë e decentralizimit apo është ndarje etnike, për më tepër, nëse kjo çështje shtrihet në monumente, gjyqësi, arsim etj. Shtrohet pyetja logjike, a kemi të bëjmë fare me decentralizim, apo ndonjë marifet politik përpiqet të na hedhë në situata të vështira? Prandaj sugjeroj që koncepti të jetë global.

Ministri-Sadri Ferati - U përgjigj se titulli i dokumentit është mirë, ngase është i titulluar për *decentralizimin*, kurse sa i përket Ligjit për kufijtë administrativë, parashihen 38 komuna për Kosovën dhe thuhet se do të vazhdojnë ende. Po të ishte vetëm Dragashi, do të ishte lehtë, por janë edhe **200** komuna të tjera. Kryetarja falënderoi ministrin për prezantimin e tij dhe kaloi në pikën e fundit të rendit të ditës.

Të ndryshme

Pasi nuk kishte diskutues për këtë pikë kryetarja e përfundoi mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 13 : 30

Procesverbali e hartoi
Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetare e Komisionit

Zylfije Hundozi